

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
DREJTORIA E POLITIKËS MONETARE DHE E HULUMTIMIT



Treguesit më të ri makroekonomik
Rishikim i gjendjes aktuale

mars 2024

Treguesit më të ri makroekonomik

Rishikim i gjendjes aktuale - ndikimet mbi politikën monetare

Rishikimi i gjendjes aktuale ka për qëllim të japë pasqyrë të dhënave më të reja makroekonomike (dhjetor 2023 - shkurt 2023) dhe krahasim me parashikimet e fundit makroekonomike (tetor 2023). Me këtë do të përcaktohet se si gjendja aktuale në ekonomi korrespondon me lëvizjet e pritshme të variablave në ciklin e fundit të parashikimeve. Rishikimi është i fokusuar në ndryshimet e supozimeve dhe arritjeve të jashtme të variablave të brendshme dhe mënyrën se si këto ndryshime reflektojnë në ambientin e udhëheqjes së politikës monetare.

Parashikimet më të reja të organizatava ndërkombëtare¹ tregojnë për perspektiva pak më të favorshme për rritjen ekonomike globale në afat të shkurtër, me rishikim në rritje të vlerësimit për vitin 2023 dhe të parashikimit për vitin 2024, ndërsa parashikimi për vitin 2025 është i pandryshuar. **Rreziqet rreth rritjes globale janë vlerësuar si të balancuara.** Njëkohësisht, rreziku kryesor negativ i referohet rritjes së tensioneve gjeopolitike, veçanërisht Lindjes së Mesme, me efekt të pafavorshëm mbi çmimet e energjisë dhe zinxhirët e furnizimit, dhe rreziqet e tjera vijnë nga ruajtja e mundshme e inflacionit bazë në nivel më të lartë për periudhë më të gjatë kohore dhe me atë ruajtjen e politikës monetare kufizuese për periudhë më të gjatë kohore, thellimi i krizës së ndërtimit në Kinë, konsolidimi fiskal më i fortë se sa pritej, fragmentimi i mëtejshëm i tregtisë globale dhe rreziqet që lidhen me ndryshimet klimatike. Nga ana tjetër, rreziqet më të favorshme për rritjen globale janë të lidhura me rënien e mundshme më të fortë të inflacionit se sa pritej që mund të ndikon më shpejt ngadalësimi i kushteve financiare, tërheqja më e ngadaltë e mbështetjes nga politika fiskale, rikuperimi më i shpejtë ekonomik i Kinës, zhvillimi i intelegjencës artificiale dhe zbatimi më i shpejtë i reformave në pjesën e ofertës agregate në vendet me rritje të shpejtë dhe në zhvillim.

Shikuar përmes treguesve të veçantë sasiorë të mjedisit të jashtëm domethënës për ekonominë maqedonase, vlerësimi për rritjen e **kërkesës së huaj efektive** për vitin 2023 është i pandryshuar në raport me muajin tetor, dhe rishikim i lehtë rënës është bërë për periudhën 2024 - 2025, ndërsa parashikimet për **inflacionin e huaj efektiv** për të njëjtën periudhë janë të ngjashme me ato të tetorit. Te kursi valutor, edhe më tej pritet zhvlerësimi i USD-dollarit në raport me euron, i cili mesatarisht për periudhën 2024-2025 është minimalisht më i ulët krahasuar me pritjet e muajit tetor. Te **çmimet botërore të produkteve primare** janë bërë rishikime kryesisht rënëse në mesatare për vitin 2024 dhe 2025, ku edhe më tej pritet rënie e çmimeve në vitin 2024 dhe stabilizim relativ i tyre në vitin 2025. Megjithatë, lëvizjet dhe vlerësimet e produkteve primare janë jashtzakonisht të ndryshueshme dhe nën ndikim të fuqishëm nga zhvillimet e lidhura me luftën në Ukrainë dhe konfliktin ushtarak në Lindjen e Afërt, që shkakton një pasiguri të madhe rreth dinamikës së tyre të ardhshme dhe efekteve ndaj ekonomisë globale dhe të brendshme.

Lidhur me **normën e interesit të huaj EURIBOR** me afatizim njëmuor, vlerësimi për vitin 2024 është rishikuar lehtësisht në rritje dhe për vitin 2025 lehtësisht në rënie krahasuar me parashikimin e tetorit, që është në pajtim me pritjet për uljen e normave të interesit të BQE-së në gjysmën e dytë të vitit 2024. Gjegjësisht, në muajin mars BQE-ja mori vendimin për ruajtjen e normave të interesit në nivelin aktual, duke vlerësuar se presionet e çmimeve të brendshme edhe më tej janë të larta, ndërsa mbajtja e normave të ineteresit e këtij niveli për një kohë mjaft të gjatë do të kontribuojë në arritjen e objektivit të inflacionit prej 2% në afat të mesëm. Njëkohësisht, sipas parashikimeve më të reje të BQE-së, vlerësimet e inflacionit janë rishikuar në rënie në krahasim me muajin dhjetor të vitit 2023, veçanërisht për vitin 2024, kur pritet ajo të shënojë 2,3% dhe pastaj të reduktohet në 2% dhe 1,9% në vitin 2025 dhe 2026, respektivisht². Lidhur me parashikimet për rritjen ekonomike, për vitin 2024 është bërë rishikim rënës, ku pritet rritje prej 0,6%, pas së cilës pritet

¹ Sipas raportit të përditësuar të FMN-së "Rishikimi Ekonomik Botëror", janar 2024.

²Në dhjetor ishin parashikuar norma e inflacionit prej 2,7%, 2,1% dhe 1,9% në vitin 2024, 2025 dhe 2026.

rimëkëmbja e ekonomisë dhe normat e rritjes prej 1,5% dhe 1,6% në 2025 dhe 2026, respektivisht, ngjashëm si në parashikimet e dhjetorit³.

Treguesit më të ri të ekonomisë së brendshme tregojnë një paraqitje makroekonomike e cila është kryesisht në pajtim me parashikimet e tetorit, por me devijime të caktuara në segmente të veçanta. Në tremujorin e katërt të vitit 2023 **rritja reale e PBB-së shënon 0,9% në bazë vjetore** (pas rritjes prej 1% në tremujorin e mëparshëm), me rritje të mëtejshme në bazë tremujore (sipas të dhënave të përshtatura sezonale dhe kalendarike të ESHS-së). Realizimet janë më të ulëta krahasuar me rritjen e parashikuar për këtë tremujor nga cikli i parashikimeve të tetorit (3,8%). Analizuar sipas komponentëve, rritja është e lëvizshme nga eksporti-neto, plotësuar me rritjen e mëtejshme solide dhe nga konsumi personal, dhe kontribut të moderuar ka konsumi publik. Investimet-bruto edhe më tej shënojnë rënie reale të lartë në kushte të rënies së madhe të rezervave për shkak të bazë së lartë krahasuese të vitit të kaluar lidhur me akumulimin e rezervave të lëndëve të para dhe energjensave. Për tërë vitin 2023, rritja reale e PBB-së shënon 1,0% dhe është më i ulët nga rritja e parashikuar në kuadër të ciklit të parashikimeve të tetorit (1,9%). Të dhënat me frekencë të lartë për tremujorin e parë të vitit 2024 me të cilat disponon për momentin janë të kufizuara. Për momentin të dhënat për muajin janar tregojnë rritje solide të prodhimit industrial, derisa qarkullimi në tregtinë totale shënoi rënie reale. **Në shkurt të vitit 2024 norma vjetore e inflacionit vazhdoi të ngadalësohet dhe u reduktua në 3%** (3,2% në muajin paraprak), që është pak nën normën e parashikuar të ciklit të parashikimeve të tetorit, si rezultat i devijimit të çmimit të ushqimit dhe energjisë. Në kushte të shterjes së ndjeshme të presionit nga komponenta ushqimore dhe energjetike, norma vjetore e inflacionit kryesisht nxitet nga komponenta bazë, e cila gjithashtu po ngadalësohet. **Pritjet e konsumatorëve** të dhëna në anketat e shkurtit për lëvizjet e çmimeve në periudhën e ardhshme janë më të favorshme krahasuar me janarin, gjegjësisht mbizotërojnë pritshmëritë për uljen e çmimeve. **Diferenca në raport me inflacionin në Eurozonë** mbetet i ulët, edhe pse në janar shënoi rritje të lehtë, në kushte të përshtetimit të moderuar të inflacionit të brendshëm dhe stabilizimi i caktuar në Eurozonë. Rishikimet në lidhje me çmimet e importit për momentin janë kryesisht në rënie, por pasiguria lidhur me ndërprerjen e rëndësisë së masave të përkohshme në çmimet e brendshme të ushqimit, si dhe të dinamikës së ardhshme të çmimeve të produkteve primare në bursa shkaku i tensioneve gjeopolitike dhe ndryshimeve klimatike është ende e pranishme.

Rezervat valutore në fund të shkurtit të vitit 2024 shënojnë 4.348,1 milionë euro. **Analiza e treguesve të mjaftueshmërisë së rezervave valutore tregon se ato edhe më tej mbahen në zonën e sigurtë.** Të dhënat për shkëmbimin e tregtisë së jashtme në janar 2024 për momentin tregojnë në deficit tregtar për tremujorin e parë të vitit që është disi më i lartë se sa pritej në pajtim me parashikimin e tetorit. Të dhënat për veprimtarinë e këmbimit përfundimisht me muajin shkurt, tregojnë në të hyra-neto nga transferimet private të cilat janë disi më të ulëta se sa pritej për tremujorin e parë në pajtim me parashikimin e tetorit. Deficiti i realizuar në llogarinë rrjedhëse të bilancit të pagesave në tremujorin e katërt të vitit 2023 është më i ulët se sa pritej në pajtim me parashikimet e tetorit, gjatë realizimit të njëkohshëm të hyrat financiare neto më të ulëta.

Lidhur me **lëvizjet e sektorit monetar, depozitat** totale në janar 2024 janë më të larta për 10,3% në bazë vjetore, me një rritje të parashikuar për tremujorin e parë prej 9,1% sipas parashikimit të tetorit. Rritja e **kredive totale** në sektorin privat në janar 2024 janë më larta për 5,7%, me rritje vjetore të parashikuar për tremujorin e parë prej 5,2% sipas parashikimit të tetorit. Njëkohësisht, me rritjen e kredive të reja është rritur, që rezulton nga dy llojet e sektorëve (ndërmarrjeve dhe amvisërive). Konkretisht, shumat e totalit të kredive të reja në sektorin privat në 12 muajt e fundit me përfundim në janar, mesatarisht është më i lartë në bazë vjetore.

Në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në janari 2024 është arritur deficit prej 2.802 milionë denarë, ose 8% të deficitit të planifikuar për vitin 2024. Deficiti buxhetor është financiar


³Në parashikimet e dhjetorit, rritja e parashikuar e PBB-së shënonte 0,8% në vitin 2024 dhe 1,5% në vitin 2025 dhe 2026.

përmes detyrimit neto të shtetit nga jashtë, si dhe të tregut të brendshëm, me akumulimin e mjeteve të depozitave të shtetit në Bankën Popullore.

Zhvillimet më të fundit të treguesve makroekonomik janë kryesisht në harmoni me pritjet e parashikimeve të fundit. Norma vjetore e inflacionit edhe më tej ngadalësohet, dhe realizimet me shkurtin e vitit 2024 për momentin janë më të mira se sa pritej dhe gradualisht afrohen në mesataren historike. Sinjalet nga anketat për pritjet inflacioniste gjithashtu janë të favorshme, gjegjësisht në shkurt tashmë mbizotërojnë pritje për uljen e çmimeve në periudhën e ardhshme. Çmimet e produkteve primare të bursave vazhdojnë me përshtatjen rënëse, dhe njëkohësisht edhe parashikimet për periudhën e ardhshme janë rishikuar në rënie. Megjithatë, ende mungon transferim më i theksuar i lëvizjeve të bursave në çmimet e brendshme të çmimit, dhe e pranishme është edhe pasiguria për shkak të konflikteve aktuale ushtarake, si për shkak të ndërprerjes së masave të përkohshme për një pjesë të produkteve ushqimore vendase. Rritja e ekonomisë vendase në tremujorin e fundit të vitit 2023, si dhe për tërë vitin, është nën të parashikuarin, që tregon në ngadalësim më të fuqishëm të rritjes ekonomike në vitin 2023 se sa pritej. Të dhënat e disponueshme për tremujroin e parë të vitit 2024 për momentin janë të kufizuara dhe të pafavorshme për kuptimin e dinamikës së aktivitetit ekonomik. Lëvizjet e tregut valutor janë të favorshme, me të hyra të mëtejshme të larta dhe të tregut këmbimor. Potenciali depozitar i bankave vazhdon të rritet, pak më fuqishëm sesa pritej, ndërsa rritja e mbështetjes kreditore të sektori privat vazhdom me dinamikë të moderuar, kryesisht afër me parashikimin.

[illegible][illegible]

Kërkesa e huaj efektive (ndryshime vjetore në %)




Në pikëpamje të **kërkesës së huaj**, vlerësimet për 2023 janë të pandryshuara...

...ndërsa për dy vitet e ardhshme është kryer korrigjim i vogël në rënie të normës së rritjes në raport të tetorit.

Burimi: "Consensus Forecast" dhe vlerësimet e BPRMV-së.

Kërkesa e huaj efektive (ndryshime vjetore në %)




Në vitin 2023, **inflacioni i huaj efektiv** është minimalisht më i lartë se sa pritej në tetor...

...ndërsa për vitin 2024 dhe 2025, vlerësimet janë të ngjashme me të tetorit, ku edhe më tej pritet ngadalësimi i saj.

Burimi: "Consensus Forecast" dhe vlerësimet e BPRMV-së.

Kursi euro/USD-dollar




Te **kursi valutor euro/USD-dollar**, edhe më tej pritet dobësimi i vlerës së USD dollarit në vitet 2024-2025, por me intenzitet të vëll nga parashikimet e tetorit.

Burimi: "Consensus Forecast" dhe vlerësimet e BPRMV-së.

Nafta "brent"


(mesatarja tremujore, euro/fuçi)



Burimi: FMN-ja , Banka Botërore dhe Iloqaritjet e BPRMV-së.

Çmimet e nikelit dhe bakrit në euro


(ndryshime vjetore në %)



Burimi: FMN-ja , Banka Botërore dhe Iloqaritjet e BPRMV-së.

Çmimet e grurit dhe misrit në euro

(ndryshime vjetore në %)



Burimi: FMN-ja , Banka Botërore dhe Iloqaritjet e BPRMV-së.


Pritshmëritë për çmimet e produkteve primare për vitin 2024 dhe 2025 në mesatare janë rishikuar në rënie, përveç te çmimet e bakrit...

...ndërsa te nafta ajo është reflektim i pritshmërive për kërkesë më të dobët, për shkak të perspektivave të përkeqësura globale ekonomike, përderisa te ushqimi dhe nikeli vjen si pasojë e pritshmërive për ofertë më të lartë....

... dhe rishikimi në rritje të çmimit të bakrit është kombinim nga produkti i uljes me kërkesë në rritje nga industria e energjisë së ripërtëritshme.

Euribor-i njëmuor

(mesatarja tremujore, në %)




Te **Euribor-i njëmuor** janë kryer korrigjime të lehta në rritje për vitin 2024, dhe disa në rënie për vitin 2025...

...por edhe më tej me pritjet e lëvizjes graduale në rënie, në linjë me pritjet për ulje të normave të interesit të BQE-së në gjysmën e dytë të vitit aktual.

Burimi: "Consensus Forecast" dhe vlerësimet e BPRMV-së.


Tregues e stresin financiar



Treguesi për stresin global financiar⁴ vazhdon të tregojë luhatshmëri në tregjet financiare.


⁴ Tregues KFI IFS (ang. OFR, FSI) e mat stresin sistematik financiar - çrregullime në funksionimin normal të tregjeve financiare. Ai përbëhet nga 33 tregues të luatshtëm të tregut financiar, të mbledhur në pesë kategori: Kredi, vlerësim të kapitalit, financim, fonde të sigurta/pa rrezik dhe paqëndrueshmëria. Vlera e treguesit, në ditë të caktuar paraqet nivel mesatar të ponderuar të çdo luhatje të shënuar atë ditë, lidhur me vlerën e tij historike, ku treguesi është pozitiv kur niveli i stresit është mbi mesataren dhe negativ kur niveli i stresit është nën mesataren.

Norma e infalcionit
(kontributet vjetore në inflacionin total, në p.p.)




Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës dhe vlerësimet e BPRMV-së.

Inflacioni dhe çmimet e ushqimit dhe energjisë
(ndryshimet vjetore, në %)



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës dhe vlerësimet e BPRMV-së.

Kontributet në normën vjetore të inflacionit (në p.p.)



Burimi: EShS-ja dhe BPRMV-

Në shkurt 2024, çmimet e brendshme të konsumit shënuan rritje të lehtë prej 0,4% në bazë mujore (-0,4% në janar) kryesisht shkak i rritjes së çmimeve të komponentit ushqimor.

Çmimet e produkteve ushqimore janë rritur për 0,5%, me çmime më të larta te shumica e kategorive të produkteve, dhe më së shumti te perimet, që pjesërisht vjen shkak i efekteve sezonale.


Çmimet e energjisë shënuan rritje mujore prej 1,0%, si rezultat i rritjes së çmimeve të derivateve të naftës, në pajtim me lëvizjet e bursave botërore.

Inflacioni bazë në bazë mujore arrin 0,2%, kryesisht shkak i rritjes sezonale të çmimeve të produkteve për higjienë personale dhe të automobilave. Në veprim të kundërt ndikoi ulja sezonale e çmimeve të trafikut ajror.

Norma vjetore e inflacionit në shkurt shënoi ngadalësim të lehtë dhe shënon 3,0% (3,2% në janar), që kryesisht vjen shkak i ngadalësimit të inflacionit bazë. Rritje më të ulët shënojnë edhe çmimet dhe ushqimi⁵, pjesërisht për shkak të bazës së lartë krahasuese, ndërsa kontributi i komponentës energjetike shënoi përshpejtim.


⁵Qeveria e RMV-së vendosi aplikimin e masave në raport të çmimeve të garantuara të produkteve ushqimore dhe përcaktimin e marzhit më të lartë tregtar në tregtinë me pemë të freskëta dhe perime të vazhdojë deri në fund të shkurtit 2024 (lidhja), ndërsa në aplikim ishte edhe vendimi për uljen e detyrimeve të importit gjatë importit me perime të freskëta, që gjithashtu, është me vlefshmëri deri në shkurt të vitit 2024 (lidhja).

Diferenca ndërmjet inflacionit vendas dhe inflacionit në Eurozonë (në p.p.)




Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës dhe Eurostat.

Pritshmëritë e konsumatorëve për ndryshimet e çmimeve në 12 muajt e ardhshëm (balance të përgjigjeve)



Burimi: Komisioni European

Parashikimet inflacionare të udhëheqësve të ndërmarrjeve për 3 muajt e ardhshëm (bilancet e përgjigjeve)



Burimi: Komisioni European

Diferenca⁶ në raport me inflacionin në Eurozonë mbetet e ulët, edhe pse në janar shënoi rritje të lehtë, në kushte të përshpejtimit të moderuar të inflacionit të brendshëm në vend dhe stabilizimi i caktuar në Eurozonë.

Pritjet e konsumatorëve⁷ të dhëna në anketat e shkurtit për lëvizjet e çmimeve në periudhën e ardhshme janë tregojnë ulje të lehtë të tyre.


Lidhur me **sektorin korporativ⁸**, pritjet për lëvizjen e çmimeve në periudhën e ardhshme janë më të favorshme në industrinë e përpunimit, ndërsa më pak të favorshme në sektorin e shërbimit, tregtinë me pakicë dhe ndërtimtarinë.

⁶ Për llogaritjen e diferencës ndërmjet inflacionit në vend dhe inflacionit në Eurozonë janë përdorur të dhëna nga Eurostat për indeksin e harmonizuar të çmimeve të konsumit, për të cilin të dhënat e fundit të publikuara janë për muajin janar.

⁷ Anketa e Komisionit European për optimizmin e konsumit nga shkurti 2024, në bazë të çështjes për "pritjet e konsumatorëve për ndryshimet e çmimeve në 12 muajt e ardhshëm".

⁸ Anketa për tendencat afariste të Komisionit European në industrinë, tregtinë me pakicë, ndërtimtarinë dhe sektorin e shërbimit.

Çmimet e huaja efektive* dhe të brendshme të ushqimit dhe pijet joalkoolike (treguesi, 2015= 100)




* Çmimet e huaja efektive të ushqimit janë marrë si përmbledhje e ponderuar nga çmimet e ushqimit në vendet që janë partnerë më të rëndësishëm tregtar të Maqedonisë së Veriut në fushën e importit të ushqimit.

Burimi: EShS-ja, Eurostat dhe llogaritjet e BPRMV-së.

Norma vjetore e realizuar e inflacionit realizuar në shkurt është pak më e ulët nga norma e parashikuar nga cikli i parashikimeve të tetorit.


Rishikimet e lëvizjeve të pritshme të supozimeve hyrëse të jashtme të parashikimi i inflacionit për vitin 2024 janë kryesisht në drejtim rënës. Njëkohësisht, ende është e madhe pasiguria rreth dinamikës së ardhshme të çmimeve të produkteve primare të bursave botërore.

Paga mesatare e paguar (normat vjetore, në %)



Burimi: EShS-ja.

Paga mesatare mujore neto e paguar sipas sektorëve (normat nominale vjetore, në %)



Burimi: EShS-ja.

Në dhjetor 2023 **paga mesatare neto nominale** shënoi rritje të mëtjshme vjetore, që paraqet përshpejtim minimal në raport me rritjen e shënuar në tremujorin paraprak...

...me përshpejtim më të madh të rritjes të "drejtoria publike dhe mborjtja; sigurimi i detyrueshëm social", "furnizimi me energji elektrike, gas, avull dhe ajër të kondicionuar", dhe "ndërtimtaria", dhe njëkohësisht këto veprimtari kanë rritje më të lartë të shënuar në bazë vjetore.

Paga reale neto në dhjetor edhe më tej shënoi rritje, në pajtim me më të lartë nominale të pagave të rritjes së inflacionit. Shikuar në mënyrë dinamike, rritja reale vjetore e pagave minimale ngadalsohet.

Ndryshimi i realizuar nominal dhe real i pagave në tremujorin e katërt të vitit 2023 është pak më i lartë krahasuar me normat e pritshme për tremujorin e katërt në kuadër të parashikimit të tetorit.

Tregu i punës⁹ në tremujorin e katërt të vitit 2023 shënoi lëvizje negative të moderuar në bazë tremujore.

Norma e punësimit u ul për 0,3 p.p. dhe shënoi 45,4% në kushte të uljes prej 0,8% të numrit të personave të punësuar në raport të tremujorit paraprak.

Norma e papunësisë shënoi rritje minimale dhe shënoi 13%, me rritjen e numrit të personave të papunësuar prej 0,8%.

Nga pikëpamja e ofertës së fuqisë punëtore, në tremujorin e katërt është vërejtur ulje e lehtë e popullsisë aktive (për 0,6%), në kushte të rritjes te popullsia joaktive (për 0,6%).


Në tremujorin e katërt të vitit 2023 rritja reale e PBB-së është 0,9% në bazë vjetore (rritje prej 1% në tremujorin paraprak)...

...që është më e ulët se rritja e parashikuar për këtë tremujor nga cikli i parashikimeve të tetorit.

Shikuar nga shpenzimet e PBB-së, rritja në tremujorin e katërt vjen si pasojë e kontributit pozitiv të eksportit-neto, në kushte të rënies së importit kundrejt rritjes minimale të eksportit të mallrave dhe shërbimeve. Kërkesa e brendshme shënoi kontribut negativ në rritjen, me rënie reale të lartë të vërejtur të investimeve bruto (në kushte të rënies së madhe të rezervave), ndërsa konsumi publik dhe personal shënojnë rritje.

Duke parë nga ana e prodhimit të PBB-së, rritja edhe në tremujorin e katërt në masë më të madhe vjen si pasojë e kontributit pozitiv të grupit të veprimtarive "tregti, transport dhe hotelieri", ndërtimtaria dhe industria, dhe kontribut pozitiv shtesë shënojnë edhe "veprimtaria lidhur me patundshmëritë", "informacione dhe komunikime", si dhe "veprimtari financiare dhe veprimtaritë e sigurimeve"

**Prodhimi i brendshëm bruto
(normat reale vjetore, në %)**



Burimi: EShS-ja dhe llogaritjet e BPRMV-së.

Dallimet në seri në periudhën e arritur janë për shkak të rishikimeve të rregullta të EShS-së.

⁹ Rezultatet nga Anketa e Fuqisë Puntore (AFP) sipas tremujorëve të vitit 2023 nuk janë të krahasueshme me të dhënat e tremujorëve të kaluar nga vitet e kaluara, sepse në vitin 2023 është zbatuar Rregullativa e re (BE) nr. 2019/1700 të Parlamentit Europian dhe Këshillit për Statistikë Sociale dhe rregullativën përkatëse ekzekutuese të Komisionit (BE) nr. 2019/2240 për zonën e fuqisë puntore, ndërsa Rregullativa e mëparshme (BE) nr. 577/98 është hequr. Zbatimi i rregullativës së re shkaktoi ndryshime në hulumtimin, duke filluar me ndryshime në dizajnin e pyetësorit, ndryshimin e renditjes së pyetjeve, ndryshime dhe largim të pyetjeve ekzistuese dhe shtimi i pyetjeve të reja, ndryshime në përfshirje dhe definimin e punësisë dhe papunësisë. Pë këtë, në këtë tremujor bëjmë analizë vetëm në bazë të të dhënave të krahasueshme nga viti 2023, gjegjësisht analizën e ndryshimeve tremujore.

Në bazë tremujore, PBB-ja shënoi rritje reale prej 0,4%¹⁰.

Në kushte të shtrirjes së kufizuar të të dhënave të disponueshme, është e vështirë të jepet vlerësim i saktë për gjendjen e përgjithshme në ekonominë në tremujorin e parë të vitit 2024.

Rezultatet nga hulumtimet e anketave për periudhën janar-shkurt të vitit 2024 tregojnë për perspektiva më të favorshme në raport me tremujorin e parë të vitit 2023, si dhe në raport me tremujorin paraprak¹¹.


Në janar, **prodhimi industrial** shënoi rritje reale në bazë vjetore, më të madhë në raport me rritjen në muajin paraprak...

...në tërësi si rezultat i rritjes së industrisë së përpunimit (para së gjithash në prodhimin e mjeteve motorike, prodhimin e metaleve dhe riparimit dhe instalimit të makinave dhe pajisjeve), ndërsa të minierat dhe të energjia vërehet kontribut negativ.

Nga ana tjetër, në janar **qarkullimi në tregtinë totale** shënoi rënie reale në bazë vjetore, kundrejt rritjes së lehtë në tremujorin paraprak...


...në kushte të rënies në të tre llojet e tregtisë (tregtia me pakicë, tregtia me shumicë dhe tregtia me mjete motorike).

Treguesi i besueshmërisë ekonomike dhe PBB-ja



Burimi: EShS-ja dhe Komisioni Europian

Sektorët ekonomikë
(ndryshimet reale vjetore, në %)




* Mesatarja e thjeshtë e normave vjetore të ndryshimit të mënyrave të ndryshme të transportit dhe telekomunikacionit.
Burimi: EShS-ja dhe llogaritjet e BPRMV-së.

PRODIMI INDUSTRIAL DHE VEPRIMTARI TË TJERA EKONOMIKE												
	2021				2022				2023			
	tr.1	tr.2	tr.3	tr.4	tr.1	tr.2	tr.3	tr.4	tr.1	tr.2	tr.3	tr.4
ndryshime reale vjetore në %												
Produkti bruto i brendshëm	0.8	15.4	1.9	1.5	1.7	4.0	1.8	1.5	1.4	0.9	1.0	0.9
Prodhim industrial	-6.1	22.3	-3.5	-2.3	3.4	1.3	-1.8	-3.4	0.1	2.7	-0.6	0.4
Punimet e realizuara ndërtimore	-1.1	-9.6	-10.8	-17.5	-11.1	-1.2	-19.2	-14.0	14.7	-21.2	-8.4	8.7
Ndërtim i lartë	18.5	5.3	-20.2	-20.9	-26.0	15.2	-8.8	6.7	15.6	-19.7	-9.8	-19.8
Ndërtim i ulët	-16.1	-16.9	-3.5	-15.2	5.1	-11.3	-25.9	-26.9	13.9	-22.3	-7.2	34.8
Qarkullim në tregtinë me shumicë - Gj	0.9	22.5	16.9	10.4	9.7	4.0	0.4	-2.7	3.7	-5.2	-6.3	0.2
Qarkullim në tregtinë me pakicë*	-1.3	18.3	13.9	10.0	7.6	6.7	1.9	-3.7	1.4	-8.1	-9.8	-2.8
Qarkullim në tregtinë me shumicë*	3.7	27.9	28.4	19.6	11.0	2.4	-1.3	-3.0	3.8	-3.9	-4.4	2.0


* Rritjet reale të rritjes llogariten nga BPRMV-ja, duke përdorur normat nominale të rritjes me inflacionin vjetor, të matur sipas shpenzimeve të jetesës. Të dhënat e tregtisë në 2020, 2020, 2021, 2022 dhe 2023 janë të dhëna të ardhshme, ndërsa të dhënat e PBB-së në 2021 dhe 2022 janë të ardhshme ndërsa për Burimi: EShS-ja dhe llogaritjet e BPRMV-së.

¹⁰ Sipas të dhënave të përshtatura sezonale dhe kalendarike të ESHS-së.

¹¹ I referohet anketave të zbatuara nga Komisioni Europian për matjen e besueshmërisë ekonomike të subjekteve në një ekonomi. Treguesi i përbërë i besimit ekonomik fitohet si mesatare e ponderuar e treguesve të besimit për konsumatorët dhe treguesve të besimit për sektorë të caktuar ekonomik (ndërtimtari, industri, tregti me pakicë dhe shërbime).

Treguesit e lëvizjes së konsumit personal
(normat reale vjetore, në %)

Burimi: EShS-ja dhe llogaritjet e BPRMV-së.

Treguesit e lëvizjes së investimeve bruto
(normat reale vjetore, në %)

Burimi: EShS-ja dhe llogaritjet e BPRMV-së.

Treguesit e disponueshëm të **kërkesës agregate** gjithashtu janë në shtrirje të kufizuar relative, që pengon formimin më të saktë të vlerësimit për lëvizjen e komponentëve të veçantë të kërkesës në tremujorin e parë të vitit 2024.


Të dhënat e disponueshme për lëvizjet e **konsumi personal** për janar 2024 kryesisht lëvizin në drejtim të rritjes, kështu vërehet rritja e pensioneve, importi i mallrave për konsum të gjerë, kreditet e popullsisë, dhe të hyrat bruto nga TVSh-ja, ndërsa te tregtia me pakicë edhe prodhimi vendas të mallrave të konsumit vërehet rënie.

Lidhur me të dhënat me frekuencë të lartë të janarit për **investimet bruto**, lëvizjet janë gjithashtu kryesisht në drejtim të rritjes...
...me rritjen te prodhimi vendas i produkteve kapitale, tatimi mbi fitimin, importi i mjeteve për punë, rezervat e produkteve të gatshme dhe kreditë afatgjata të ndërmarrjeve, ndërsa investimet shtetërore kapitale shënojnë rënie të ndjeshme.

Të dhënat për **shkëmbimin e jashtëm tregtar** në janar të vitit 2024 tregojnë në rritje të mundshme të deficitit në raport të periudhës së njëjtë nga viti i kaluar, me rënie më të fortë nominale të eksportit në raport me rënien e importit të mallrave.

Realizimet buxhetore në pajtim me të dhënat fiskale për periudhën janar 2024 tregojnë për një rritje reale vjetore të **konsumit publik**.

Eksport sipas komponentave
(kontribute në ndryshimin vjetor, në p.p.)




Burimi: BPRMV.

Deficiti në shkëmbimin e mallrave me vendet e huaja në janar 2024 u rrit për 9,4% në bazë vjetore, me rënie më të theksuar të eksportit krahasuar me rënien e importit të mallrave.

Importi i mallrave në janar 2024 shënoi rënie prej 11,4% në bazë vjetore, për shkak të eksportit më të ulët të një pjese të kapaciteteve të prodhimit në pronësi të huaj nga industria e automjeteve, si dhe për shkak të eksportit më të ulët të energjisë (për shkak të energjisë elektrike). Realizimet të importit për momentin janë më të ulëta se sa pritej me parashikimet e tetorit.


Import sipas komponentave
(kontribute në ndryshimin vjetor, në p.p.)



Burimi: BPRMV.

Importi i mallrave në janar të vitit 2024 shënoi rënie prej 5,8% në bazë vjetore, për të cilën kontributin më të madh ende e ka importi më i ulët i energjisë. Kontribut më të ulët të importit të hekurit dhe çelikut, si dhe import më të ulët të një pjese nga kapacitetet e prodhimit në pronësi të huaj nga industria e automjeteve. Krahasuar me parashikimin e tetorit, realizimet të importit për momentin janë të ulëta.


KREK
norma vjetore e ndryshimit, në %



Burimi: BPRMV.

Deficiti tregtar në janar 2024 për momentin është pak më i lartë se sa pritej në pajtim me parashikimet e tetorit.


**KKEN-ja dhe çmimet relative
normat vjetore të ndryshimit, në %**




Në janar 2024, treguesit e KREK-ut shënuan mbivlerësim në bazë vjetore, nën ndikim të rritjes së mbivlerës së KNEK-it (kryesisht shkaku i zhvlerësimit të lirës turke dhe rublës ruse në raport me denarin), me rënie të kostove relative të jetës dhe rritje të lehtë të çmimeve relative të produkteve industriale.

Te treguesit e KREK-ut sipas llogaritjes me ponderët e bazuar në shkëmbimin e tregtisë së jashtme pa produkte primare janë regjistruar lëvizje të ngjashme, përveç te KREK-u i deflatuar me kostot e jetës që shënoi zhvlerësim minimal.

**KREK, nuk ka produkte parësore
norma vjetore e ndryshimit, në %**






**Komponentët e llogarisë rrjedhëse
(milionë euro)**



Në tremujorin e katërt të vitit 2023, llogaria rrjedhëse shënoi deficit prej 111,7 milionë euro, ose 0,8% të PBB-së, që është më i ulët se sa pritej sipas parashikimeve të tetorit...

...me realizimin e deficitit tregtar më të ulët (korrigjim në rënie te importi) dhe suficit më të lartë te shërbimet.


Në vitin 2023 llogaria rrjedhëse realizoi suficit, kundrejt deficitit të parashikuar me parashikimin e tetorit. Devijime më të rëndësishme pozitive janë regjistruar te bilanci tregtar, deficitin e cilës është më i ulët se sa pritej, si dhe te shërbimet, ku është realizuar suficit më i lartë.

Komponentët e llogarisë rrjedhëse
(në milionë euro)Komponentët e llogarisë rrjedhëse
(në milionë euro)Komponentët e llogarisë rrjedhëse
(në milionë euro)

Në tremujorin e katërt të vitit 2023, te llogaria financiare janë realizuar të hyrat neto ¹² prej 684,4 milionë euro (ose 5% të PBB-së), të cilat janë më të ulëta se sa pritej në pajtim me parashikimet e tetorit (me realizime më të dobëta te kreditet tregtare, si dhe te kreditë afatgjata, ndërsa më të mira te valutat dhe depozitat dhe te investimet direkte).

Në vitin 2023, llogaria financiare realizoi të hyra neto që janë më të ulëta se sa pritej, në pajtim me parashikimet e tetorit. Njëkohësisht, devijimet negative janë regjistruar te kreditë (të hyra më të ulëta neto se sa pritej) dhe te investimet portfolio (të realizuara të dalat neto kundrejt të hyrave neto se sa pritej), me realizime më të mira te valutat dhe depozitat dhe te investimet direkte.

¹² Sipas metodologjisë së re për përgatitjen e bilancit të pagesave (BPM6), terminet të hyra neto dhe të dala neto shënojnë krijimin e detyrimit neto dhe fitim neto të mjeteve, respektivisht.



*Me përfundim më 29.2.2024

**Parashikimet tetor 2023.

Burimi: BPRMV.

Blerja neto e tregut të këmbimit i realizuar në periudhën 1.1.2024 - 29.2.2024 shënoi ulje të lehtë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar dhe për momentin tregon për arritje të transferimeve private që janë pak më të ulëta se sa pritej për tremujori e parë, në pajtim me parashikimin e tetorit.




*Të dhënat e fundit të disponueshme: 29.2.2024


Burimi: BPRMV.

Rezervat valutore bruto në fund të shkurtit të vitit 2024 shënojnë 4.348,1 milionë euro dhe shënojnë ulje në raport të fundit të tremujorit të katërt të vitit 2023, që në pjesë më të madhe vjen si pasojë e operacioneve të Bankës Popullore për menaxhim me rezervat valutore.


Faktorë të ndryshimit të rezervave valutore (në milionë euro)



SEKTORI I JASHTËM




Në periudhën 01.01 - 29.02 të vitit 2024, në tregun valutor të bankave është regjistruar blerje neto e valutave që është më e lartë në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, në kushte të rritjes pak më të fortë të kërkesës në raport me rritjen e ofertës së valutave.




Analiza sektoriale tregon se zhvendosjet e tilla të tregut valutor në pjesë më të madhe vijnë nga shitja më e lartë neto e kompanive.

Instrumente monetare (gjendjet në fund të muajit, në milionë denarë)



Gjendja e instrumenteve monetare në fund të janarit 2024 shënoi ulje krahasuar me muajin paraprak, që vjen si pasojë e uljes së sasisë së mjeteve të bankave të vendosura në depozita te Banka Popullore.

Niveli i instrumenteve monetare në fund të janarit është pak më i ulët në krahasim me nivelin e parashikuar për fundin e tremujorit të parë të vitit 2024, me aktivë neto më të ulët të valutave të Bankës Popullore dhe një devijim më të ulët në rënie në totalin e depozitave të shtetit krahasuar me parashikimet e tetorit, njëkohësisht me nivel më të lartë të parave primare nga parashikimi.




*Parashikimi për instrumentet monetare është pa repo transaksionet
Burimi: BPRMV-ja


Realizimet te paratë primare në fund të janarit, janë mbi vlerësimet e parashikuara sipas parashikimeve të tetorit si rezultat i rritjes së rezervave totale të bankave te Banka Popullore dhe rritje të lehtë të parave të gatshme në qarkullim.

Depozita në total

(kontribute në p.p., ndryshime mujore)



(kontribute në p.p., ndryshime vjetore)



- Depozita të sektoreve tjera*
- Depozita në valutë të huaj
- Depozita të ndërmarrjeve
- Depozita, / ndryshim mujore/vjetor, në %
- Depozita në valutë të brendshme
- Para të depozituara
- Depozita të amvisërive
- Depozita, / ndryshime vjetor, në %

*Në depozita të sektoreve tjera janë të përfshira depozita të institucioneve financiare tjera, depozitat e vetëqeverisjes lokale dhe depozitave të institucioneve jofitimprurëse që u shërbejnë amvisërive të bankat, si dhe depozitat e transferueshme në denarë të institucioneve tjera financiare dhe të vetëqeverisjes lokale të Banka Popullore


Depozitat totale¹³ në sistemin financiar, shënuan ndryshim negativ të parëndësishëm në janar 2024 krahasuar me muajin paraprak, me ndryshime të lehta te depozitat sipas sektorëve dhe sipas vautës.

Depozitat totale në janar të vitit 2024 shënojnë ulje të lehtë në raport me tremujorin paraprak, me rënie më të lartë që pritet për tremujorin e parë, në pajtim me parashikime të tetorit.


Norma vjetore e rritjes të depozitave totale janar 2024 është 10,3% dhe e njëjta për momentin është mbi normën e parashikuar për tremujorin e parë të vitit 2024 prej 9,1%.

Depozita të amvisërive

(kontributet në p.p, ndryshimet mujore)



(kontribute në p.p., ndryshime vjetore)



- Para të depozituara
- Depozita të amvisërive në valutë të brendshme
- Depozita të amvisërive në valutë të huaj
- Depozita afatgjata të amvisërive
- Depozita afatshkurtra të amvisërive
- Depozita të amvisërive, ndryshime mujore/vjetore, në %


Burimi: BPRMV.

Në janar 2024 është realizuar rënie e parëndësishme mujore të **depozitave të amvisërive**, me rritjen e muajit të kaluar, me rënien e parave të depozituara dhe rritjen e kursimit në valutën e brendshme dhe të huaj. Në bazë vjetore, depozitat e amvisërive janar 2024 shënojnë rritje prej 7,8%.

¹³ Të dhënat i referohen depozitave të sektorit joshitetor të bankave dhe kursimoreve, mjeteve të institucioneve tjera financiare në llogaritë të BPRMV-ja dhe mejtet e njëjste të vetqeverisjes lokale në llogaritë të BPRMV-ja. Të dhënat korrespondojnë me ndryshimet metodologjike të BPRMV-së nga qershori 2018. Më shumë informacione për ndryshimet metodologjike mund të gjeni në këtë lidhje: http://www.nbrm.mk/monetarna_statistika_i_statistika_na_kamatni_stapki.nspj.


Depozita në denarë dhe valutë të amvisërive/totali i depozitave të amvisërive

(pjesëmarrje në fund të muajit, në përqindje)



Respektivisht, të lehta janë ndryshimet edhe në strukturën valutore të depozitave totale të amvisërive në janar të vitit 2024.


(pjesëmarrje në fund të vitit, në përqindje)



*Totali i depozitave vetëm në banka dhe kursimoret.


Oferta monetare M4

(kontribute në p.p., ndryshime mujore)



Oferta monetare e shprehur përmes agregatit monetar më të gjërë M4, në janar 2023, shënoi rënie të lehtë prej 0,3%, që kryesisht vjen si rezultat i rënies së parave depozituese dhe parave të gatshme në qarkullim. Nga aspekti afatit, rritje të lehtë ka te depozitat afatgjata dhe afatshkurtra, ndërsa nga aspekti valutore, rritje shënojnë edhe depozitat në denarë dhe në valuta të huaja.

(kontribute në p.p., ndryshime vjetore)




Në nivel vjetor, oferta monetare në janar 2024 shënoi rritje prej 10%, që është mbi rritjen e pritur vjetore prej 8,5% për tremujorin e parë të vitit 2024, sipas parashikimit të tetorit.

Strukturë me afat: GPO jashtë nga institucionet depozitare, Totali i depozitave afatshkurtra, Totali i depozitave në valutë, Totali i depozitave në denarë, Totali i depozitave afatgjata. Strukturë valutore: Para të depozituara, Totali i depozitave në denarë, Totali i depozitave afatgjata. M4, ndryshime vjetore, në % Burimi: BPRMV.


Pjesëmarrje e M4 pjesë në denarë në totalin e ofertës monetare M4

të dhënat në fund të muajit, në %



Pjesëmarrja e pjesës së denarit në ofertën totale monetare M4 në janar 2024, është pak më e ulët krahasuar me muajin paraprak dhe është mbi vlerën e parashikuar për tremujorin e parë të vitit.


të dhënat në fund të vitit, në %



Burimi: BPRMV.

Kredite në total


(kontribute në p.p., ndryshime mujore)




Kreditë totale në janar shënuan rënie të lehtë mujore prej 0,2%.

Në janar të vitit 2023, kreditë totale u ulën në raport me tremujorin paraprak, që është në kuadër të rënies që pritet për tremujorin e parë të vitit, sipas parashikimeve të tetorit.

(kontribute në p.p., ndryshime vjetore)




Norma vjetore e rritjes së kredive totale në janar shënon 5,7% dhe e njëjta sështë nën rritjen vjetore prej 5,2% të parashikuar për tremujorin e parë të vitit 2024, sipas parashikimeve të tetorit.




Burimi: BPRMV.

**Kredi të reja të sektorit privat, 12M mesatarja
lëvizëse, norma vjetore të rritjes**




Shuma e totalit të kredive të reja në sektorin privat në 12 muajt e fundit me përfundim në janar mesatarisht është pak më i lartë në bazë vjetore, lëvizur nga kreditimi i sektorit korporativ dhe të amvisërive.

**Kredi të reja të amvisërive, 12M mesatarja
lëvizëse, norma vjetore të rritjes**




**Kredi të reja të ndërmarrjeve, 12M mesatarja
lëvizëse, normat vjetore të rritjes**



**Raporti ndërmjet kredive totale dhe depozitave
(të dhënat mujore, në përqindje)**




Shfrytëzimi i potencialit depozitues për kreditimin e sektorit privat ka shënuar rënie të lehtë në janar dhe është nën vlerën e këtij treguesi të parashikuar në fund të tremujorit të parë të vitit 2024, sipas parashikimit të tetorit.




Burimi: BPRMV.

Norma e interesit të totalit të depozitave
(të dhëna mujore, në përqindje)




(Të dhënat në fund të vitit, në përqindje)




Burimi: BPRMV-ja

Norma e interesit të totalit depozita të amvisërive
(të dhënat mujore, në përqindje)



Total depozita

depozita të reja



Burimi: BPRMV-ja


Në janar 2024 **normat e interesit të depozitave totale në denarë**¹⁴ shënuan rënie të lehtë, me ulje të barabartë të normave të interesit në totalin e depozitave në denarë dhe depozitave në valuta të huaja, që kontribuoi në diferencë të pandryshuar të interesit. Lëvizje minimale në rënie të normave të interesit në këtë muaj ka te **totali i depozitave të reja në denarë dhe në valutë të huaj**¹⁵, me reflektim më të madh të normave të interesit të depozitave të reja në valuta të huaja, që e rriti diferencën e interesit për 0,1 p.p....

...lëvizje identike në janar vërehen edhe te normat përkatëse të interesit te sektori "amvisëritë", përveç te depozitat e reja në denarë ku ka lëvizje të lehtë rritëse.

¹⁴ Të dhënat për normat e interesit janë në pajtim me ndryshimet metodologjike të BPRMV-së nga qershori 2018. Më shumë informacione për ndryshimet metodologjike mund të gjeni në këtë lidhje: http://www.nbrm.mk/monetarna_statistika_i_statistika_na_kamatni_stapki.nspk.


¹⁵ Lidhur me normat e interesit të kredive të reja duhet të merret parasysh se këto lëvizje janë karakteristike për ato. Ndryshueshmëria e normave të interesit të kredive të reja vjen nga fakti se ato janë të kushtëzuara nga vëllimi i kredive të reja (të cilat nga muaji në muaj mund të ndryshon) dhe norma e tyre e interesit.

Norma e interesit të totalit të kredite, sipas sektorëve
(ndryshime mujor, në përqindje)




Në janar 2024, normat e interesit të **totalit të kredive të amvisërive dhe totalit të kredive të ndërmarrjeve shënojnë rritje të lehtë në raport me muajin paraprak**. Rritje të lehtë shënojnë normat e interesit të **kredive të reja**¹⁶ të amvisërive, ndërsa te ndërmarrjet ndryshimi është në rënie.

(Të dhënat në fund të vitit, në përqindje)



Burimi: BPRMV-ja


Normat e interesit bazë të BPRMV-së dhe BQE-së (në%) dhe diferenca e tyre (në p.p.)



Diferenca në normat bazë të ineteresit të Bankës Popullore dhe të Bankës Qendrore Europiane është e qëndrueshme dhe e pa ndryshuar.


¹⁶ Lidhur me normat e interesit të kredive të reja duhet të merret parasysh se këto lëvizje janë karakteristike për ato. Ndryshueshmëria e normave të interesit të kredive të reja vjen nga fakti se ato janë të kushtëzuara nga vëllimi i kredive të reja (të cilat nga muaji në muaj mund të ndryshohet) dhe norma e tyre e interesit.

Të hyrat dhe shpenzimet buxhetore (kontribute në ndyshimin vjetor, në p.p.)



Në janar 2024, të hyrat në buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut (buxheti qendror dhe buxhetet e fondeve) realizuan rritje solide vjetore, por më të ndjeshme ishin rritur edhe shpenzimet buxhetore (transerimet e rritura në kategoritë e cënueshme sociale të qytetarëve).

Realizimi i Buxhetit, sipas kategorive (Buxheti qendror dhe fondet), në përqindje nga plani vjetor




Deficiti i realizuar buxhetor në shumë prej 2.802 milionë denarë paraqet 8,0% të deficitit të planifikuar për vitin 2024 në pajtim me Buxhetin ¹⁷.

Burimi: Ministria e Financave dhe llogaritjet e BPRMV-së.

¹⁷ "Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 283 prej më datë 28.12.2023.


Financim i bilancit buxhetor (në miliona denarë)



*ndryshimi pozitiv: ulja e depozitave të BPRMV; ndryshimi negativ: rritja e depozitave të BPRMV.
Burimi: Ministria e Financave

... i njëjti është financuar përmes detyrimit neto të shtetit nga jashtë¹⁸ dhe detyrim neto më të moderuar të shtetit në tregun e brendshëm, me akumulimin e depozitave të shtetit në Bankën Popullore.


Norma e interesit të letrave me vlerë shtetërore në përqindje



Burimi: Ministria e Financave.

Në shkurt të vitit 2024, në ankandet e rregullta, Ministria e Financave i zvogëloi normat e interesit të sapoemetuara bonot shtetërore dymbëdhjetë mujore, në 4,0% dhe në pesëmbëdhjetë obligacionet shtetërore pa klauzolë valutore, në 5,9%. Pas një periudhe të gjatë u emetuan pesëmbëdhjetë obligacionet shtetërore pa klauzolë valutore, me normë interesi mesatare të ponderuar prej 4,50%.

¹⁸ Në janar të vitit 2024, është kryer tërheqja e kështit të dytë prej 155 milionë euro si pjesë nga programi KLL (Linja e kujdesit dhe likuiditetit) të Fondit Monetare Ndërkombëtar.



Burimi: Llogaritjet e BPRMV-së në bazë të të dhënave nga Ministria e Financave.

Në fund të tremujorit të katërt të vitit 2023 është shënuar rritje e **borxhit publik**¹⁹, nën ndikimin e rritjes edhe të borxhit publik të brendshëm dhe atij të jashtëm.

¹⁹ Borxhi publik është definuar me Ligjin për Borxhin Publik ("Gazeta Zyrtare e RM" numër 62/2005, 88/2008, 35/2011, 139/2014 dhe 98/2019) sipas të cilës paraqet përmblendje të borxhit shtetëror dhe borxhit të ndërmarrjeve publike të bazuara nga shteti ose nga komunat, komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit, si dhe shoqëritë tregtare që janë me pronësi të plotë ose të shumicës së shtetit ose të komunave, komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit.

Shtojca 1: Kategoritë treguese të konsumit personal dhe investimeve bruto

KATEGORI INDIKATIVE E KONSUMIT PERSONAL

	2021				2022				2023				2024
	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	jan.
	<i>ndryshime reale vjetore në %</i>												
Qarkullim në tregtinë me pakicë*	-1.3	18.3	13.9	10.0	7.6	6.7	1.9	-3.7	1.4	-8.1	-9.8	-2.8	-4.5
Të hyra bruto nga TVSh-ja*	2.9	36.6	21.1	20.6	29.2	9.5	3.7	-7.7	-15.0	-9.5	-10.7	-1.5	2.5
Import i mallrave për konsum të gjerë*	3.2	26.2	11.4	13.9	-2.9	-1.5	-2.1	-10.1	2.0	4.8	1.4	14.7	15.5
Prodhimi i brendshëm i mallrave të konsumit	-9.4	17.1	-5.6	5.1	2.2	-1.2	3.2	-3.6	6.4	4.9	-7.5	-1.2	-9.5
Kreditë e popullsisë*	4.7	5.7	4.0	3.2	-0.5	-5.6	-9.2	-9.3	-6.6	-2.4	0.0	3.1	3.7
Paga mesatare neto*	2.0	5.7	1.1	0.7	0.0	-1.7	-4.6	-4.6	-2.8	3.6	6.6	12.8	-
Borxhi privat neto*	9.5	66.5	55.5	14.2	9.8	24.1	11.8	5.1	11.3	-8.4	-10.4	-1.6	-
Pensione*	2.3	0.3	0.0	-1.8	-3.4	-1.0	-10.4	-4.9	-2.5	1.3	9.9	13.4	18.4

*ritjet reale të rritjes llogariten nga BPRMV-ja, duke pjesëtuar normat nominale të rritjes me inflacionin vjetor, të matur sipas shpenzimeve të jetesës.

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës, Ministria e Financave dhe llogaritjet e BPRMV-së.

KATEGORITË E INVESTIMEVE INDIKATIVE

	2021				2022				2023				2024
	tr.1	tr.2	tr.3	tr.4	tr.1	tr.2	tr.3	tr.4	tr.1	tr.2	tr.3	tr.4	jan.
	<i>ndryshime reale vjetore në %, përveç për SDI ndryshimet në shumat reale janë në miliona denarë</i>												
Import i mjeteve për punë*	8.9	64.2	6.5	4.7	6.8	5.5	10.9	-1.4	-3.8	-1.9	-5.4	3.1	6.9
Punimet e realizuara ndërtimore**	-1.1	-9.6	-10.8	-17.5	-11.1	-1.2	-19.2	-14.0	14.7	-21.2	-8.4	8.7	-
Prodhimi i brendshëm i produkteve kapitale	-7.3	59.6	-24.3	-22.3	0.9	3.3	18.6	3.7	6.7	8.2	6.7	17.9	41.2
Investime shtetërore kapitale*	166.5	3.7	56.2	9.3	-16.4	25.0	-47.4	55.6	-6.8	312.9	29.1	-4.0	-18.4
Investime direkte***	-11603.9	16657.2	1695.1	10455.2	9616.2	-6348.6	10624.7	262.4	1114.2	-2027.8	-8584.4	-1964.3	-
Kredi afatgjatë të ndërmarrjeve*	7.3	2.5	0.7	3.9	2.2	-2.2	-6.5	-6.7	-5.0	1.2	3.4	3.9	4.6
Inventari i produkteve të gatshme	2.0	9.7	16.1	12.4	11.5	9.2	11.1	10.5	-3.1	-2.4	-3.8	-0.6	5.5

*ritjet reale të rritjes llogariten nga BPRMV-ja, duke pjesëtuar normat nominale të rritjes me inflacionin vjetor, të matur sipas shpenzimeve të jetesës.

**ritjet reale të rritjes përftohen duke përdorur normën e rritjes së deflatorit të shpenzimeve të ndërtimit të banesave të reja.

***shumat reale llogariten nga BPRMV-ja, duke pjesëtuar shumat nominale me nivelin e indeksit të çmimeve të konsumit (viti bazë: 2023= 100).

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës, Ministria e Financave dhe llogaritjet e BPRMV-së.